

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150, si dhe nenin 40 të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 4 shkurt 2026, miratoi këtë:

## POLITIKË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË BANKËN QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### Neni 1

#### Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Politikë përcakton të drejtat përgjegjësitë dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat përpunohen nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj ligjor.
2. Kjo Politikë zbatohet nga BQK, për të gjitha proceset ku kërkohet përpunim i të dhënave personale në çfarëdo forme dhe përfshin të gjithë personat fizikë, në raport me BQK-në.

### Neni 2

#### Përkufizimet

1. Të gjitha termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Politikë kanë kuptimin e njëjtë siç janë përcaktuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe apo për qëllime të kësaj politike si në vijim:
  - 1.1.E dhënë personale – çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave,;); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.
  - 1.2.Të dhëna biometrike – të gjitha të dhënat personale që rezultojnë nga përpunimi specifik që kanë të bëjnë me karakteristikat fizike, psikologjike ose të sjelljes së një personi fizik që lejon ose konfirmon identifikimin unik të atij personi fizik si dhe imazhet pamore ose të dhënat

daktiloskopike, psikologjike dhe të sjelljes, që i kanë të gjithë individët, por që janë të veçanta dhe të përhershme për secilin individ, nëse në veçanti mund të përdoren për identifikimin e një individi, siç janë: gjurmët e gishtërinjve, vijat papilare të gishtit, irida, retina, tiparet e fytyrës dhe ADN-ja.

- 1.3. Përpunim - është çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi.
- 1.4. Kontrollues i të dhënave - është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, si institucion publik, e cila përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale në ushtrimin e kompetencave të saj ligjore.
- 1.5. Përpunues i të dhënave - çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat i cili përpunon të dhënat personale për dhe në llogari të BQK-së.
- 1.6. Pëlqim i subjektit të të dhënave - shprehje e lirë e vullnetit të dhënë lirisht, specifik, të informuar dhe të qartë të dëshirave të subjektit të të dhënave nëpërmjet të cilit ai ose ajo, me një deklaram ose me një veprim të qartë pohues, shpreh pëlqimin e tij/saj për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të.
- 1.7. Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia) - agjenci e pavarur, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për qasje në dokumente publike dhe mbrojtje të të dhënave personale.
- 1.8. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale - anëtar i stafit të BQK, i caktuar me vendim të veçantë sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### **Neni 3**

#### **Parimet e përpunimit të të dhënave**

1. BQK gjatë ushtrimit të mandatit të saj ligjor mbledh dhe përpunon të dhëna personale duke u bazuar në parimet e përpunimit të të dhënave personale si:
  - 1.1. Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës - të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.
  - 1.2. Parimi i kufizimit të qëllimit - të dhënat personale duhet të grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk do të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime.
  - 1.3. Parimi i minimizimit të të dhënave – të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe të kufizuara vetëm në ato që janë të nevojshme në lidhje me qëllimin e përpunimit.
  - 1.4. Parimi i saktësisë – të dhënat duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara.
  - 1.5. Parimi i kufizimit të ruajtjes – të dhënat personale mund të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përmbushjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligjin përkatës për arkivat shtetërore ose akte të brendshme përkatëse të BQK-së.



1.6. Parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit – të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative.

1.7. Parimi i llogaridhënies - duhet të sigurohet përgjegjësi për përpunimin e të dhënave duke respektuar të gjitha parimet e përcaktuara në këtë nen.

#### **Neni 4**

##### **Baza ligjore për përpunim**

1. BQK përpunon të dhënat personale të subjekteve vetëm nëse zbatohet, të paktën, njëri nga kriteret e mëposhtme:
  - 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike;
  - 1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës;
  - 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet BQK-ja;
  - 1.4. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë;
  - 1.5. nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë BQK-së;
  - 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga BQK ose pala e tretë;
  - 1.7. rastet tjera të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### **Neni 5**

##### **Kategoria/lloji i të dhënave që përpunohen**

1. Në varësi të qëllimeve ligjore dhe arsyeve specifike BQK përpunon të gjitha ose disa nga të dhënat personale të specifikuara më poshtë, ndaras ose në kombinim midis tyre:
  - 1.1. Të dhënat e identifikimit: emri, mbiemri, numër personal, datëlindje, adresë;
  - 1.2. Të dhënat biometrike;
  - 1.3. Të dhënat e kontaktit: adresa e banimit, adresa elektronike, numri i telefonit;
  - 1.4. Të dhënat financiare dhe ekonomike;
  - 1.5. Të dhënat për arsimin, kualifikimin profesional dhe veprimtarinë e punës;
  - 1.6. Të dhënat shëndetësore;



1.7. Të dhëna të tjera të kërkuara sipas ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës ose marrëdhëniet kontraktuale.

## **Neni 6**

### **Qëllimi i përpunimit**

1. BQK përpunon të dhënat personale vetëm për qëllime të ligjshme dhe të përcaktuara qartë, si vijon:
  - 1.1. Përbushja e mandatit ligjor dhe detyrimeve të BQK-së, përfshirë mbikëqyrjen, rregullimin dhe licencimin e institucioneve financiare;
  - 1.2. Ofrimi dhe administrimi i shërbimeve publike, përfshirë Regjistrin e Kredive, Regjistrin e Llogarive dhe sisteme të tjera, të nevojshme për funksionimin e rregullt, të sigurt dhe efikas të sektorit financiar;
  - 1.3. Trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve të shërbimeve financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - 1.4. Administrimi i marrëdhënieve të punës me personelin dhe kandidatët për punësim, përfshirë trajtimin e ankesave nga marrëdhënia e punës dhe procesi i rekrutimit;
  - 1.5. Përbushja e obligimeve të tjera ligjore ose kontraktuale që burojnë nga legjislacioni përkatës;
  - 1.6. Garantimi i sigurisë së personelit, pronës dhe infrastrukturës së institucionit, si dhe parandalimi i qasjes së paautorizuar dhe incidenteve të sigurisë.

## **Neni 7**

### **Të drejtat e subjektit të të dhënave**

1. Subjekti i të dhënave, të dhënat personale të të cilit përpunohen nga BQK-ja, gëzon të gjitha të drejtat e garantuara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Në veçanti, subjekti i të dhënave ka të drejtë:
  - 2.1. të informohet në mënyrë të qartë, të drejtë dhe transparente për mënyrën e mbledhjes, përdorimit dhe ruajtjes së të dhënave të tij personale nga BQK;
  - 2.2. të qaset në të dhënat e veta personale që përpunohen nga BQK dhe të marrë kopje të tyre;
  - 2.3. të kërkojë korrigjimin ose përditësimin e të dhënave personale që janë të pasakta, të paplota ose të vjetruara;
  - 2.4. të kërkojë fshirjen ("e drejta për t'u harruar,") e të dhënave personale, nëse përpunimi nuk është më i nevojshëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur, ose nëse përpunimi është i paligjshëm;
  - 2.5. të kufizojë përpunimin e të dhënave të veta në rrethana të caktuara të parashikuara me ligj;
  - 2.6. të kundërshtojë përpunimin e të dhënave të veta personale, nëse përpunimi bazohet në interes legjitim të BQK-së;
  - 2.7. të kërkojë bartjen (transferimin) e të dhënave personale tek një kontrollues tjetër, kur kjo është teknikisht e mundur dhe në përputhje me ligjin;



2.8. të kërkojë që çdo korrigjim, fshirje ose kufizim i përpunimit t'u komunikohet palëve të treta, të cilave u janë zbuluar të dhënat, përveç rasteve kur kjo është e pamundur ose kërkon përpjekje disproporcionale.

3. Subjekti i të dhënave mund të ushtrojë të drejtat e tij duke paraqitur kërkesë me shkrim në adresën zyrtare të BQK-së ose përmes emailit zyrtar të Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të publikuar në ueb faqen zyrtare të BQK-së.
4. Çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, ka të drejtë të paraqesë ankesë në Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

## **Neni 8**

### **Vëzhgimi me kamerë**

1. BQK mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesës së saj për aq sa konsiderohet e nevojshme për sigurinë e personave fizikë dhe sigurimin e pasurisë.
2. Në hapësirat ku janë të instaluar sistemet e vëzhgimit me kamerë duhet të vendoset njoftimin i dukshëm se hapësira është e vëzhguar me kamerë.
3. BQK si kontrollues i të dhënave krijon një sistem të dosjes për regjistrimin e sistemeve të vëzhgimit me kamerë. Sistemi i dosjeve, veçmas nga regjistrimet (pamjet), përmban datën, vendin, kohën e regjistrimit dhe se ku ruhen regjistrimet.
4. Regjistrimet nga vëzhgimi me kamerë mund të ruhen deri në (1) muaj, përveç nëse nuk kërkohet ndryshe për qëllime legjitime.
5. Të dhënat e mbledhura nga vëzhgimi me kamerë mund të përpunohen apo të shfrytëzohen, nëse është e nevojshme, për të arritur qëllimet e synuara dhe nëse nuk ekzistojnë indikacione të shkeljes së interesave legjitime të subjektit të të dhënave. Këto të dhëna mund të përpunohen apo të shfrytëzohen për qëllime të tjera, vetëm nëse janë të nevojshme për të parandaluar kërcënimet ndaj shtetit dhe sigurisë publike, apo për të ndjekur penalisht krimet.
6. Sistemi i vëzhgimit me kamerë dhe regjistrimet e vëzhgimit duhet të mbrohen në mënyrë të duhur nga qasja dhe përdorimi i paautorizuar.
7. Përpunimi i incizimeve të kamerave të sigurisë bëhet me një autorizim të veçantë, i cili do të lëshohet për secilin rast.

## **Neni 9**

### **Përdorimi i karakteristikave biometrike**

Përdorimi i karakteristikave biometrike bëhet vetëm nëse është e domosdoshme për sigurinë e personave fizikë, sigurimin e pronës ose mbrojtjen e të dhënave konfidenciale, nëse kjo nuk mund të arrihet me mjete më të lehta.

## **Neni 10**

### **Qasja në të dhënat personale**

1. Qasja në të dhënat personale që ruhen dhe përpunohen nga BQK lejohet vetëm për personat e autorizuar dhe për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Personat e autorizuar duhet të respektojnë konfidencialitetin e të dhënave dhe të përdorin të dhënat vetëm për realizimin e detyrave zyrtare.
3. Varësisht nga lloji i të dhënave, autoritetet e zbatimit të ligjit mund të kenë qasje në këto të dhëna duke respektuar ligjet në fuqi dhe procedurat e brendshme të sigurisë.
4. Çdo qasje e paautorizuar në të dhënat personale është e ndaluar dhe trajtohet sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të brendshme të BQK-së.
5. Kërkesat për qasje në dokumente publike, të cilat përmbajnë të dhëna personale, trajtohen nga Zyrtari për Qasje të Dokumenteve Publike në bashkëpunim me Zyrtarin për Mbrojtje të të Dhënave Personale në përputhje me dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit për Mbrojtje të të Dhënave Personale.

## **Neni 11**

### **Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale**

1. BQK me vendim cakton Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili përfshihet, në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në BQK ka detyrat e mëposhtme:
  - 2.1. informon dhe këshillon BQK-në, respektivisht të punësuarit, të cilët kryejnë përpunimin mbi detyrimet e tyre në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave;
  - 2.2. jep këshilla, sipas rastit, në lidhje me vlerësimin e ndikimit në privatësi mbi mbrojtjen e të dhënave dhe monitoron performancën në pajtim me nenin 35 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ;
  - 2.3. bashkëpunon me Agjencinë;
  - 2.4. vepron si pikë kontakti për Agjencinë për çështjet në lidhje me përpunimin, duke përfshirë konsultimin paraprak dhe konsultohet, sipas rastit, në lidhje me çdo çështje tjetër.
3. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përmbushje të detyrave të tij ose të saj, merr parasysh si duhet rrezikun që shoqëron veprimet e përpunimit, duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit.
4. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mund të jetë anëtar personeli i BQK-së i caktuar mbi bazën e kualifikimit profesional dhe veçanërisht, përvojës dhe ekspertizës për mbrojtjen e të dhënave, dhe aftësisë për të përmbushur detyrat e përcaktuara në nenin 39 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. BQK ose përpunuesi publikon hollësitë e kontaktit të Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ia komunikon Agjencisë.

6. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr udhëzime në lidhje me ushtrimin e detyrave të tij. Ai nuk mund të pushohet apo penalizohet nga BQK për përmbushjen e detyrave të tij.
7. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale raporton drejtpërdrejt në nivelin më të lartë menaxhues të BQK-së.

## **Neni 12**

### **Konfidencialiteti për përpunimin e të dhënave personale**

1. Zyrtari i BQK-së që përpunon të dhëna personale apo është në dijeni me të dhënat e përpunuara nuk mund t'ua bëjë të njohur përmbajtjen e këtyre të dhënave personale të tjerë.
2. Çdo zyrtar i BQK-së detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë dhe të mbrojë fshehtësinë e të dhënave personale edhe pas ndërprerjes së ushtrimit të këtyre detyrave.

## **Neni 13**

### **Siguria e të dhënave personale**

1. BQK ndërmerr masa teknike dhe organizative për të garantuar nivelin e duhur të sigurisë gjatë përpunimit të të dhënave personale, duke përfshirë mbrojtjen kundër përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe kundër humbjes, shkatërrimit ose dëmtimit aksidental.
2. Masat, procedurat dhe standardet teknike e organizative për garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave rregullohen me Politikën për Sigurinë e Informacionit në BQK.
3. Në raste të shkeljes së sigurisë së të dhënave personale, BQK njofton Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe, kur është e nevojshme, subjektet e të dhënave, në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## **Neni 14**

### **Afati i ruajtjes së të dhënave personale**

1. BQK i ruan të dhënat personale vetëm për periudhën e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve për të cilat ato janë mbledhur dhe përpunuar, siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj Politike.
2. Afati i ruajtjes së të dhënave përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme të BQK-së, për secilën prej kategorive të të dhënave.
3. Pas përfundimit të periudhës së ruajtjes, të dhënat personale fshihen, shkatërrohen ose anonimizohen, përveç rasteve kur ligji kërkon ruajtjen e tyre për një periudhë më të gjatë.
4. Dokumentacioni që përmban të dhëna personale, i cili ka vlerë arkivore, trajtohet në përputhje me legjislacionin për arkivat.



**Neni 15**  
**Vlerësimi i ndikimit në privatësi**

1. BQK zbaton parimin e privatësisë që në fazën e projektimit dhe siguron që sistemet e reja, si dhe ato ekzistuese që pësojnë ndryshime thelbësore dhe përpunojnë të dhëna personale, t'i nënshtrohen vlerësimit të aspekteve të privatësisë, përfshirë, sipas rastit, kryerjen e vlerësimit të ndikimit në privatësi.
2. BQK kërkon këshillën e Zyrtarit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, për kryerjen e vlerësimit të ndikimit në privatësi mbi mbrojtjen e të dhënave.
3. Vlerësimi i ndikimit në privatësi duhet të përfshijë:
  - 3.1.Vlerësimin e mënyrës së përpunimit të të dhënave personale dhe qëllimit të përpunimit;
  - 3.2.Vlerësimin nëse përpunimi i propozuar i të dhënave personale është i domosdoshëm dhe proporcional me qëllimin/-et;
  - 3.3.Vlerësimin e rreziqeve për individët gjatë përpunimit të të dhënave personale;
  - 3.4. Identifikimin e masave të nevojshme për të adresuar rreziqet e identifikuar dhe për të demonstruar përputhshmëri me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. BQK duhet të marrë në konsideratë përdorimin e teknikave si minimizimi i të dhënave dhe pseudonimizimi, kur është e zbatueshme dhe e përshtatshme.

**Neni 16**  
**Shkeljet dhe gjokat administrative**

Mosrespektimi i dispozitave të kësaj Politike, mund të rezultojë në përgjegjësi ligjore dhe masa ndëshkuese në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të vendosura nga autoriteti kompetent.

**Neni 17**  
**Hyrja në fuqi dhe publikimi**

Kjo Politikë hyn në fuqi prej datës 16 shkurt 2026 dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të BQK-së.



Ahmet Ismaili  
Kryesues i Bordit Ekzekutiv